
**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“F&J” SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“F&J” SHPK

Sot , me date 20.09.2023, ne Vlore, personat me te dhenat si me poshte:

Donald FEGA, i biri i Sabri i datelindjes 21.06.1994, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal J40621084R, i cili perfaqeson 51 % te kuotave te shoqerise.

Mandi JAHO, i biri i Leonard i datelindjes 01.02.1989, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I90201103M, i cili perfaqeson 49 % te kuotave te shoqerise.

Duke vepruar ne cilesine e Ortakeve Themelues, vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “F&J” SHPK dhe vendosi te aprovoje kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

TITULLI I

EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA

Neni 1

Emri i Shoqerise

1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria “F&J” SHPK, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

1.3 Shoqeria ka adresen e e-mail fjkonsulence@gmail.com dhe Nr.Tel +355697898130

Neni 2

Regjimi Juridik i Shoqerise


2.1 “F&J” SHPK , eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

NENI 3 Selia



3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Vlorë, lagjia “28 Nëntori”, rruga Perlat Rexhepi, z.k 8605, nr. pasurisë 44/238-N6, mbrapa sahatit, përballë lagjes muze. Vlorë.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojë shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.

Neni 4 Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

TITULLI II

OBJEKTI

Neni 5 Objekti

Ofrimin e shërbimeve të konsulencës lidhur me pronat e paluajtshme. Shërbime kadastrale, shërbime ne lidhje me legalizimet. Shërbime të administrimit të taksave dhe shërbime të tjera administrative dhe organizative. Shërbime të regjistrimit të biznesit, aplikime të ndryshme në e-albania. Shërbime te regjistrimit fillestar dhe ndryshime të tjera në regjistrin tregtar. Shërbime të tjera profesionale, në fushën e trajnimit profesional, shërbime të rekrutimit të trajnimit te punonjësve dhe shërbime e veprimtari të tjera të ngjashme. Veprimtari ekonomike ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme), qe ka te bej me negocime, ndërmjetësime, përfaqësime te të treteve ne fushën e real estate si ne tregun e brendshëm ashtu edhe ne atë ndërkombëtar. Shitje, blerje, dhënie me qira të të gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo transaksion tjetër ne funksion te përmbushjes se objektit te veprimtarisë ne fushën e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm qe ka te beje me pasuritë e paluajtshme. Veprimtari ekonomike ne fushe e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit te strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe te gjitha shërbimet direkt apo indirekt te lidhura me to, si ne tregun e brendshëm ashtu edhe ne atë ndërkombëtar; Marrja dhe/ose zhvillimi, kryerja ose ofrimi i shërbimeve ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme), qe kane te bëjnë me marketing, marrëdhënieve me publikun, ekspertize shitje apo qiradhënie apo operim/administrim turistik, menaxhimi, shërbime te studimit te tregut, shërbime te pas shitjes, ndjekja e pagesave te klientëve. Vlerësimi i te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme (urbane, rurale, komerciale, administrative, shoqërore, turistike, rezidenciale etj.) dhe asetëve (te luajtshme apo te paluajtshme) ne funksion të tyre; Administrimi i bashkëpronësisë ne ndërtesa, ne resorte apo struktura turistike dhe ne komplekse rezidenciale. Krijimi i faqeve ëeb, platformave elektronike ne internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin e aktivitetit te shoqërisë edhe nëpërmjet pajisjeve elektronike te komunikimit ne distance. Zhvillimi i pasurive te

paluajtshme, te zotërojë dhe menaxhoje pasuri te paluajtshme e te luajtshme si dhe gjithë te drejtat e tjera shtese qe lidhen me këto pasuri. Investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asetete (te prekshme apo te paprekshme). Te kryeje çdo operacioni tregtar, financiar, blerje, shitje ose marrje me qira te objekteve te ndryshme te luajtshme e te paluajtshme apo edhe titujt. Konsulencë financiare, ndërmarrje ndërmjetësimi, imobiliare, ne fushën e turizmit, ndërtimit, etj. Blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi te drejtave te pasurive te te paluajtshme dhe atyre te luajtshme si dhe titujve. Furnizimi i shërbimeve dhe punimeve me përmbajtje te larte teknike dhe profesionale si studime, kërkime, analiza dhe matje, konsulenca, organizimi dhe menaxhimi i kurseve profesionale, projektim, drejtim operativ, drejtimi i punimeve, koordinimi i sigurisë ne projektim dhe ne ekzekutimet lidhur me sektorin e arkitekturës, inxhinierisë, civile dhe industriale, mjedisore, territoriale, te infrastrukturave, te energjisë, te informacionit, te automatizmit dhe te sigurisë. Studime te fakteve, kërkime, konsulenca , vlerësime te përshtatjes teknike ekonomike, studime dhe vlerësime te impaktit mjedisor, veprime rikuperimi dhe mbrojtjes se territorit. Hetime gjeologjike, gjeoteknike, rlevime topografike, ajrofotoqrametrike dhe te çdo lloji dhe tipi. Konsulencë tekniko-ligjore ne fushën e sipërmarrjes se veprave publike dhe ekzekutimit te veprave. Aktivitete projektimi ne sektorin publik dhe privat, përfshirë mundësinë e pranimit të detyrave të konsulences, udhëzimit dhe ekzekutimit te proceseve te financimit te veprave publike ose private nga ente dhe/ose institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Organizimi dhe drejtimi për llogari te vet dhe ndaj te tretëve me furnizim te shërbimeve përkatëse te asistencës, konsulencës tekniko-tregtare te proceseve industriale, te veprave dhe impianteve te çfarëdolloj tipi. Furnizimi me sisteme informatike harduerë e softuerë dhe metoda te monitorimit te territorit. Shoqëria mund te kryeje çfarëdolloj aktiviteti industrial, tregtarë, financiar me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, mund te japë garanci personale ose reale edhe ne favor të të tretëve. Gjithashtu, ne përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund te kryeje dhe te realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt apo indirekt, është si rrjedhim apo ka te beje me objektivat e renditura me sipër. Shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6 Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 200 Lek (dyqind leke) i ndare ne 2 (dy) kuota. Kapitali i shoqerise do te paguhet nga ortakët themelues si vijon: **Donald FEGA, nenshkrues i 1 (nje) kuote, e barabarte me 51 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 102 Lek (njqind e dy leke).**

Mandi JAHQ, nenshkrues i 1 (nje) kuote, e barabarte me 49 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 98 Lek (nentedhjete e tete leke).

6.2 Pergjegjësia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga shoqeria eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakut/ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

Neni 7 Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortaket e mbetur ("Ortaket e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortaket e mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofruesit.

7.3 Ne rast se me shume se nje prej Ortakeve te mbetur deshirojne te blejne kuoten e ofruar, secili prej ketyre ortakeve te mbetur do te kete te drejten te bleje kuoten e ofruar perpjestimisht sipas perqindjeve qe zoterojne ne Shoqeri, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje periudhe prej tridhjete (30) ditesh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre deshiron te bleje kuoten e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar, sipas kushteve te percaktuara ketu, brenda tridhjete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjithë ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6 , nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht me shkrim ortakeve te tjere. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

Neni 8 Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 11 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimit te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzoje te drejten nenshkrimit, kapitali mund te nenshkruset nga ortaket e tjere. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 11 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

Neni 10

Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotate mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjitha ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Vendimet e Shoqërisë merren ne përputhje me ligjin per shoqerite tregtare.

Për të gjitha çështjet që i përkasin drejtimit, menazhimit dhe vendimeve të shoqërisë asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte të votave të ortakëve.

Asambleja e Ortakeve është organi vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te

statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos per çeshtje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve si dhe përcaktimin e pages se administratorit
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 12

Administrimi


Administratore e shoqërisë është Z. Mandi JAHO, lindur me 01.02.1989 ne Vlore (dhe banues ne Vlore, identifikuar me leternjoftimin me Nr. Personal I90201103M. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte ripertesitje duke filluar nga data 20.09.2023 deri me 19.09.2028. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te shoqërisë.

Neni 13

Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti djre nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakeve te vetem për miratim;
- d) krijojëz një/sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë



mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve në rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratori lejohet të delegojë kompetencat tek një person i tretë nëpërmjet një Prokure Noteriale, në rastin kur ai e gjykon si të nevojshëm për aktivitetin e Shoqërisë dika të tilla.

Neni 14

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve

të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

TITULLI V

VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve të shoqërisë.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të treta, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakeve të shoqërisë.

TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

Neni 19

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;
- e) kur shoqëria për dy vite rrjesht ka dale me humbje

Në këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e Shoqërisë.

Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit

të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimit sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 21

Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 22

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Neni 23

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së

re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 24

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve të Shoqërisë, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:
 - a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
 - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
 - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

TITULLI VII NDRYSHME

Neni 26

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

TITULLI VIII


AUTORIZIME

Autorizohet Administratori i Shoqerise Z. Mandi JAHO, lindur me 01.02.1989 ne Vlore dhe banues ne Vlore, identifikuar me leternjoftimin me Nr. Personal I90201103M qe te aplikojte prane Qendres Kombetare te Biznesit per depozitimin e AKT THEMELIMIT DHE STATUTIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "F&J" SHPK. I autorizuari ka te drejten e aplikimit / depozitimit / nenshkrimit dhe cdo te drejte tjeter deri ne regjistrimin e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. I autorizuari ka te drejta te pakufizuara, te kryeje cdo veprim me qellim regjistrimin e shoqerise, te nenshkruaje cdo dokument, te aplikoj dhe te terhiqet nga aplikimi etj, me qellim regjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Nënskruhet sot me date 20.09.2023.

ORTAKET E SHOQERISE "F&J" SHPK

Donald FEGA
51% te Kuotave



Mandi JAHO
49% te Kuotave

